



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Statistikat e Mirëqenies Sociale TM3 2020



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

P a r a t h ë n i e

Publikimi “Statistikat e Mirëqenies Sociale TM3 2020” përmban të dhëna për: skemën e ndihmës sociale, pensionet bazë, pensionet kontribut paguese, pensionet e personave me aftësi të kufizuara, skemën për mbështetje materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, skemën për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe veteranët e luftës, skemën e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), skemën e pensioneve të Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK), skemën e pensioneve të Minatorëve të Trepçës, skemën për personat e verbër, të dhënat për numrin e fëmijëve të braktisur, numrin e personave të vendosur në shtëpitë për persona të moshuar dhe pa përkujdesje familjare, numrin e personave me aftësi të kufizuara të vendosur në institutin special të Shtimes si dhe në shtëpitë e komunitetit etj.

Burim i këtyre të dhënave është Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) përkatësisht departamentet në vijim: Departamenti i Mirëqenies Sociale, Departamenti i Administratës Pensionale dhe Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës (DFDIL), të cilët i falënderojmë për bashkëpunim.

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim mund t’i dërgoni në adresën elektronike social@rks-gov.net .

Avni Kastrati - Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale
Naime Rexhepi - Udhëheqëse e Divizionit të Statistikave Sociale

Publikimin përgatitën:

Mirvete Fazliu - Zyrtare e lartë e Statistikave tjera Sociale
Ahmet Cakolli - Zyrtar për dizajn

Nëntor, 2020

z.v. Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së,
Ilir T. Berisha

Lista e shkurtesave

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MPMS	-	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
DFDIL	-	Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës
PPAK	-	Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara
SHPMPF	-	Shtëpitë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare
ISSH	-	Instituti Special i Shtimes
TMK	-	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
FSK	-	Forcat e Sigurisë së Kosovës
DPSF	-	Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes

Simbolet

:	-	Mungojnë të dhënat
-	-	Nuk ka dukuri

P ë r m b a j t j a

Faqe

Shpjegime për shfrytëzuesit	5
Tabela 1. Numri i familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale sipas komunave	13
Tabela 2. Numri i anëtarëve të familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale sipas komunave	14
Tabela 3. Numri i familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale sipas kategorive	15
Tabela 4. Pensionet bazike të moshës sipas komunave	16
Tabela 5. Pensionet bazike të moshës sipas nacionalitetit, gjinisë dhe pagesa	18
Tabela 6. Pensionet kontribut paguese të moshës sipas muajve	19
Tabela 7. Pensionet kontribut pagues të moshës sipas nacionalitetit gjinisë dhe pagesa	21
Tabela 8. Pensionet e personave me aftësi të kufizuara sipas komunave	22
Tabela 9. Pensionet e personave me aftësi të kufizuara sipas nacionalitetit, gjinisë dhe pagesa	24
Tabela 10. Skema për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara sipas komunave (0-18) vjeç	25
Tabela 11. Pensionet Familjare sipas komunave	27
Tabela 12. Pensionet e Invalidëve të punës sipas komunave	28
Tabela 13. Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike sipas komunave	29
Tabela 14. Skema për kompensimin e Arsimit për vitet e 90/91 deri në vitin shkollor 98/99 sipas komunave	30
Tabela 15. Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës sipas komunave në Kosovë	31
Tabela 16. Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës sipas moshës	32
Tabela 17. Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës sipas kategorive	32
Tabela 18. Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës sipas nacionalitetit, gjinisë dhe pagesa	33
Tabela 19. Skema e pensioneve për veteranët e luftës sipas komunave në Kosovës	34
Tabela 20. Skema e pensioneve për veteranët e luftës sipas moshës	35
Tabela 21. Skema e pensioneve për veteranët e luftës sipas kategorive	35
Tabela 22. Skema e pensioneve për veteranët e luftës sipas nacionalitetit, gjinisë dhe pagesa	36
Tabela 23. Skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) sipas komunave	37
Tabela 24. Skema e pensioneve të Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK) sipas komunave	38
Tabela 25. Skema e pensioneve të Minatorëve të Trepçës sipas komunave	39
Tabela 26. Skema e kompensimeve për personat e verbër sipas komunave	40
Tabela 27. Numri i fëmijëve të braktisur sipas komunave	41
Tabela 28. Numri i fëmijëve të vendosur në strehim familjar dhe në SOS fshatrat nëpër komuna	42
Tabela 29. Numri i fëmijëve pa kujdes prindëror sipas komunave	43
Tabela 30. Numri i fëmijëve që kanë shkuar në bashkim familjarë sipas komunave	44
Tabela 31. Numri i fëmijëve të larguar nga strehimi familjarë brenda familjes sipas komunave	45

Tabela 32. Numri i fëmijëve për të cilët paneli në DPSF ka dhënë pëlqimin për adoptim vendor dhe ndërkombëtar sipas komunave.....	46
Tabela 33. Numri i personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare sipas nacionalitetit të vendosur në SHPMPF në Prishtinë	47
Tabela 34. Numri i personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare sipas gjinisë të vendosur në shtëpinë e komunitetit në Skenderaj.....	47
Tabela 35. Numri i personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare sipas gjinisë të vendosur në shtëpinë e komunitetit në Gurakoc	48
Tabela 36 Numri i personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare sipas gjinisë të vendosur në shtëpinë e komunitetit në Graçanic	48
Tabela 37. Personat e vendosur në Institutin Special në Shtime sipas nacionalitetit dhe gjinisë	50
Tabela 38. Personat e vendosur në shtëpinë e komunitetit në Kamenicë sipas nacionalitetit dhe gjinisë.....	50
Tabela 39. Personat e vendosur në shtëpinë e komunitetit në Ferizaj sipas nacionalitetit dhe gjinisë.....	51
Tabela 40 Personat e vendosur në shtëpinë e komunitetit në Deçan sipas nacionalitetit dhe gjinisë.....	51
Tabela 41. Personat e vendosur në shtëpinë e komunitetit në Shtime sipas nacionalitetit dhe gjinisë.....	52
Tabela 42. Personat e vendosur në shtëpinë e fëmijëve në Shtime, sipas nacionalitetit dhe gjinisë.....	52
Tabela 43. Personat e vendosur në shtëpinë e komunitetit në Vushtrri sipas nacionalitetit dhe gjinisë.....	53
Tabela 44. Personat e vendosur në shtëpinë e komunitetit në Graçanicë, sipas nacionalitetit dhe gjinisë.....	53
Tabela 45. Personat e vendosur në shtëpinë e komunitetit në Lipjan, sipas nacionalitetit dhe gjinisë.....	54
Tabela 46. Numri i përfituesve nga skemat sociale TM2 2020	56
Tabela 47. Shuma e mjeteve të shpenzuara për pagesën e pensioneve dhe skemave tjera sociale TM2 2020.....	57

Shpjegime për shfrytëzuesit Pensionet¹

Pensioni bazik i moshës – pensioni minimal i rregullt mujor të paguar për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, që kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare, pa marrë parasysh, a kanë qenë të punësuar apo jo dhe të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj; Pensioni bazik i moshës iu paguhet të gjithë personave që janë shtetas të përhershëm të Republikës së Kosovës, të cilët posedojnë dokumentet e identifikimit dhe të cilët kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare. Shuma mujore e këtij pensioni është 90 €.

Pension kontribut pagues i moshës - është pensioni i rregullt mujor për qytetarët e punësuar në Republikën e Kosovës, të cilët i kanë paguar kontributet, në ish-Fondin Pensional të Kosovës para datës 01.01.1999 sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare KSAK-së nr. 26/83) e të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj. Të drejtën në pension kontribut pagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët: kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; duhet të ketë stazh pensional kontribut dhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999; ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999.

Personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pension kontribut pagues të moshës, nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të ndonjë skeme tjetër pensionale të përcaktuar me këtë ligj. Përrjashtimisht, shfrytëzuesit e pensionit kontribut pagues të moshës, dhe shfrytëzuesit e pensioneve tjera të përcaktuara me këtë ligj, mund të jenë edhe shtetasit e huaj, me shtetin e të cilëve, Republika e Kosovës, lidh Marrëveshje Bilaterale për sigurimet sociale.

Shuma e pensionit kontribut pagues të moshës nga muaji janar 2016 ka pësuar ndryshime ku pensionet paguhen sipas kategorizimeve në bazë të nivelit të shkollimit si në vijim :
Kategoria e parë-pensionist i pa arsimuar ose me arsim fillor – shuma e pensionit është 182 euro;
Kategoria e dytë – pensionist me arsim të mesëm- shuma e pensionit është 198 euro;
Kategoria e tretë –pensionist me arsim të lartë - shuma e pensionit është 214 euro;
Kategoria e katër –pensionist me arsim universitar- shuma e pensionit është 265 euro.

Pensionet e personave me aftësi të kufizuara – pensioni i paaftësisë së përhershme iu ofron mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me ligjin nr. 04/L-131 sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Pensioni i paaftësisë së përhershme iu paguhet të gjithë atyre personave që janë shtetas të Republikës së Kosovës, që posedojnë dokumentet e identifikimit dhe të cilët i kanë tetëmbëdhjetë (18) deri gjashtëdhjetë e pesë(65) vjeç. Një person do të konsiderohet me pa aftësi të përhershme, nëse: ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore. Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston pa aftësia e përhershme e punës te parashtruesi i kërkesës dhe vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë(5) vitesh. Pas skadimit të afateve të përcaktuara personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor. Ministria apo Autoriteti përkatës mund t'i autorizojnë zyrtarët përgjegjës për inspektime të rastësishme apo sistematike

¹Definicionet për pensionet bazike të moshës , pensionet kontribut pagues të moshës , pensionet e personave me paaftësi të përhershme dhe pensionet e parakohshme të Treçës janë marrë nga Ligji Nr.04-L-131.

të personave, të cilat marrin pensionin e paaftësisë së përhershme, me qëllim të verifikimit të fakteve të dhëna në kërkesë dhe vazhdimësisë së përzgjedhjes për shfrytëzimin e pensionit të aftësisë së kufizuar. Shuma mujore e këtij pensioni është 75 €.

Pensionet e Trepçës – Të drejtën në pension të parakohshëm e realizojnë të gjithë të punësuarit në kompleksin “Trepça” të cilët e kanë humbur vendin e punës deri në fund të vitit 2004. Pensionet iu paguhen të gjithë minatorëve të kompleksit “Trepça” nëse i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara për njohjen e të drejtës në pension të parakohshëm sipas Ligjit mbi skemat pensionale të financuara nga shteti (Ligji nr.04-L-31). Shuma mujore e pagesës është 126 €.

Pensionet e Trupave mbrojtëse të Kosovës (TMK)-pension i rregullt i TMK-së është pagesa e rregullt mujore që i bëhet ish-pjesëtarit të TMK-së gjatë tërë jetës. Po ashtu përfitues nga ky pension janë trashëgimtarët- të afërmit e varur të pensionistëve të TMK-së pas vdekjes së pensionistit si bashkëshortët, fëmijët e pensionistit të TMK-së që në kohën e vdekjes së tij – saj janë nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Shuma e pagesës së pensioneve të TMK-së përcaktohet prej 60%, 70% dhe 80% të pagës mesatare.

Pension i Forcave të Sigurisë së Kosovës- është pagesa e rregullt mujore që i paguhet pjesëtarit të FSK-së i cili i plotëson kriteret e parapara në Ligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (Ligji nr.04/L-084).Përfituesit kanë të drejtë në pensionin e FSK-së, pavarësisht nga një punësim tjetër në sektorin publik ose privat, përveç nëse ata shërbejnë sërish në FSK. Po ashtu përfitues nga ky pension pas vdekjes së pensionistit edhe bashkëshortija, fëmijët trashëgimtarë, duke përfshirë fëmijët martesor, jashtëmartesor dhe të adoptuar dhe prindërve të pensionistit nëse pensionisti nuk ka bashkëshort-e dhe fëmijë. Shuma e pagesës së pensioneve të FSK-së përcaktohet prej 60%, 70% dhe 80% të pagës mesatare.

Kompensimet për personat e verbër - I/E verbër konsiderohet personi me humbje të plotë të pamurit të lindur ose të fituar të përcaktuar sipas kriterëve mjekësorë të vlerësuara nga Komisioni Mediko-social. Komisioni Mediko-social është komisioni i përbërë prej ekspertëve mjekësor dhe social, i formuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i cili bën përcaktimin e shkallës së verbërisë, duke përfshirë kohëzgjatjen e saj, për secilin person që paraqet kërkesë për të gëzuar kompensim për shkak të verbërisë, përfitimet dhe të drejtat sipas ligjit 04/L-092. Këto pagesa bëhen çdo muaj nga Departamenti i Administratës Pensionale. Përfitimin material për shkak të verbërisë e marrin personat, pavarësisht nga mosha dhe në të njëjtën masë përfitojnë edhe shoqëruesit e të verbërve të grupit të parë, nevoja për të cilët përcaktohet nga Komisioni Mediko-social. E drejta në përfitim material të verbërisë për personat e verbër, si dhe shoqëruesit e tyre realizohet nga dita e paraqitjes së kërkesës, nëse janë plotësuar kushtet dhe kriteret për realizimin e tyre të përcaktuara në Ligjin nr.04/L-092.

Shuma e pagesës për personat e verbër është 125 € në muaj si dhe 125 € për shoqëruesit e personave të verbër.

Pensioni familjar² - pensioni i rregullt mujor i paguar për anëtarët e familjes në rast të vdekjes së të punësuarit, që ka qenë në marrëdhënie pune, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me ligjin në fuqi .

² Definicioni për Pensionin Familjar dhe Pënsionin invalidor të punës është marrur në Ligjin Nr.04/L-131

Të drejtën për pension familjar e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit familjar të cilët janë nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare dhe të cilët realizimin e kësaj të drejte e dëshmojnë me Vendim apo fletëpagesë të pensionit që tregon se kanë qenë shfrytëzues të pensionit familjar, para datës 01.01.1999, sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensionsal dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83). Shuma mujore e këtij pensioni është 90 €.

Pensioni invalidor i punës - pensioni i rregullt mujor, i paguar për personat që pësojnë lëndime në punë apo fitojnë sëmundje profesionale gjatë marrëdhënies së punës, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj, si dhe invalidët e punës sipas Ligjit Pensionsal dhe Invalidor të aplikuar para datës 01.01.1999.

Të drejtën në pension invalidor të punës e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit invalidor, nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare të cilët e dëshmojnë realizimin e kësaj të drejte me Vendim apo (fletëpagesë) të pensionit që tregon se kanë qenë shfrytëzues të pensionit invalidor të punës, sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensionsal dhe Invalidor.

E drejta në pension invalidor të punës iu njihet edhe të gjithë të punësuarve aktual, tek të cilët është shfaqur paaftësia e plotë për punë, si pasojë e lëndimit në punë apo e sëmundjes profesionale. 3. Lartësia e pensionit invalidor të punës është në shumë të njëjtë me pensionin bazik të moshës. Shuma mujore e këtij pensioni është 90 €.

Pensioni për personat paraplegjik³ - nga kjo skemë përfitojnë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme.

Pensioni për personat tetraplegjik⁴ - nga kjo skemë përfitojnë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme. 1.3 përfituesit e këtij Ligji - Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik. 1.4. Kompensim - nënkupton shumën e pagesës mujore për mbulimin e shpenzimeve të domosdoshme ditore.

Për kompensimin e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik shuma mujore me shoqërues është 375 € (Grupi I), kurse pa shoqërues është 150 € (Grupi II).

Pensionet për kompensimin e Arsimit për vitet 90-91 deri në vitin 98-99⁵ – pagesa ka filluar të implementohet nga muaji janar 2020.

Personi i pensionuar i cili ka punuar në arsimin shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, gëzon një kompensim shtesë për kontributin e dhënë. Përfituesit e kompensimit shtesë janë: 2.1. mësimdhënësit; 2.2. bashkëpunëtorët profesional; 2.3. drejtori dhe zëvendësdrejtori i shkollës; 2.4. personeli administrativ; 2.5. personeli teknik i shkollave; 2.6. të punësuarit në arsimin e lartë sipas sistemit të arsimit shqip.

Përfituesit e kompensimit shtesë kategorizohen bazuar në vitet e punës së tyre, ku për çdo vit pune, mbi pensionin që realizojnë, përfitojnë shumën e përqindjes të pagës bazë në arsimin fillor

³ - 4 Definicioni për Pensionet Paraplegjik dhe Tetraplegjik është marr në Ligjin Nr.05/L-067.

⁵. Definicioni për Pensionet për kompensimin e Arsimit për vitet 90-91 deri në vitin 98-99 është marr në Ligjin Nr. 06/L-073 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 9 / 26 Mars 2019)

të Republikës së Kosovës, si në vijim: 1.1. një (1) vit pune 3.46%; 1.2. dy (2) vite pune 5.19%; 1.3. tre (3) vite pune 6.91%; 1.4. katër (4) vite pune 8.64%; 1.5. pesë (5) vite pune 10.37%; 1.6. gjashtë (6) vite pune 12.10%; 1.7. shtatë (7) vite pune 13.83%; 1.8. tetë (8) vite pune 15.56%; 1.9. nëntë (9) vite pune 17.28%. të bazuar në Ligjin nr. 06/L-073 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 9 / 26 Mars 2019):

Familjet e dëshmorëve dhe Invalidët e luftës Dëshmor i kombit⁶- është luftëtari i UÇK-së që:

- ka rënë në luftë për lirinë e vendit;
- është plagosur në luftë për lirinë e vendit dhe ka vdekur si pasojë e plagëve të marra brenda tri (3) viteve pas përfundimit të luftës.

Invalid i luftës së UÇK-së – është luftëtari, pjesëtari dhe i internuari (burgosuri) i UÇK-së, i cili ka pësuar plagë, lëndime (dëmtime) fizike dhe psikike apo sëmundje të rënda gjatë luftës ose në burgjet dhe kampet e armikut, gjatë periudhës së luftës, me shkallë të invaliditetit së paku 10%. Invalidët me kujdestar (Invalidi i UÇK-së me shkallë të invaliditetit mbi 80% ka të drejtë në shtesë për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër).

Veteran i luftës i UÇK-së – është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK-së, dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës.

⁶ Definicioni për invalidët e luftës dhe veteranet është marr në Ligjin Nr.04/L-172.

Shuma e pagesës mujore për të gjitha kategoritë e skemës së DFDIL është si në vijim:

K a t e g o r i t ë	Shuma e pensionit
Familjet e Dëshmorëve	
Familja qe e ka dhënë një Dëshmor:	448,13 €
Familja qe I ka dhënë dy Dëshmorë:	537,76 €
Familja qe I ka dhënë tre Dëshmorë:	582,57 €
Familja qe I ka dhënë kater Dëshmorë:	627,39 €
Familja qe I ka dhënë me shumë se 4 Dëshmorë:	672,19 €
Familjet e të zhdukurve të UÇK-së	
Familja me një të zhdukur të UÇK-se	448,13 €
Familja me dy të zhdukur të UÇK-se	537,76 €
Familja me tre të zhdukur të UÇK-se	582,57 €
Familja me kater të zhdukur të UÇK-se	627,39 €
Familja me më shumë se 4 të zhdukur të UÇK-se	672,19 €
Invalidët e Luftës	
Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	448,13 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 71- 80%	412,50 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 70%	393,75 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 51- 60%	375,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 41 -50%	356,25 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 31- 40%	318,75 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 20 -30%	225,00 €
Invalidi me kujdestar	
Kujdestari per Invalidin me demtim trupor me mbi 80%	225,00 €
Familjet e Invalidëve të Luftës pas vdekjes	
Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	358,50 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 71- 80%	330,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 70%	315,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 51- 60%	300,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 41 -50%	285,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 31- 40%	255,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 20 -30%	180,00 €
Familjet e Viktimave dhe të Zhdukurve Civil	
Familja e Viktimës -të Zhdukurit Civil	168,75 €
Familja me dy Viktima - të Zhdukur	202,50 €
Familja me tre Viktima - të Zhdukur	219,38 €
Familja me katër Viktima - të Zhdukur	236,25 €
Familja me katër e më shumë Viktima -të Zhdukur	253,13 €
Invalidët Civil të Luftës	
Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	152,50 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 80%	136,25 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 40- 60%	120,00 €
Invalidi me kujdestar	
Kujdestari per Invalidin me demtim trupor me mbi 80%	50,13 €
Familjet e Invalidëve Civil të Luftës pas vdekjes	
Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	123,25 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 80%	110,25 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 40- 60%	97,25 €
Veteranet	
Veteranet Luftëtar	170,00 €
Familja e Veteranit pas vdekjes së Veteranit	119,00 €

Fëmijët e braktisur⁷

Fëmijë i braktisur pa kujdes prindëror, konsiderohet çdo fëmijë i moshës nën 18 vjeç, i cili është i braktisur nga prindërit, të cilët për shkaqe dhe arsye të ndryshme nuk i kryejnë, apo nuk janë në gjendje ti kryejnë obligimet, përgjegjësitë dhe të drejtat prindërore. Format e mbrojtjes për këtë kategori të fëmijëve janë: kujdestaria, bashkimi familjar, strehimi familjar, strehimi i përkohshëm institucional dhe adoptimi.

Shtëpia e personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare (SHMPF) në Prishtinë dhe shtëpitë me bazë në komunitet (SHBK) –Për ta fituar të drejtën për vendosje në SHPMF dhe SHBK parashtruesi i kërkesës duhet t'i plotësojë këto kriteret themelore: të jetë banorë i përhershëm i Republikës së Kosovës, të jetë mbi moshën 65 vjeçare, të mos ketë fëmijë biologjik apo të birësuar (vendosja – strehimi nuk pengohet nëse klienti në gjendje të nevojës ka vajzë e cila është e martuar), të jetë në gjendje të mirë psikike, të mos ketë sëmundje infektive. SHPMF dhe SHBK ofrojnë këto shërbime: ushqim, veshmbathje, përkujdesje shëndetësore, terapi të punës dhe shërbime fizioterapeutike.

Instituti Special i Shtimes dhe me shtëpitë bazë me komunitet – ofrojnë këto shërbime për rezidentët: ushqim, veshmbathje, përkujdesje shëndetësore, terapi të punës, edukative dhe aftësuese, trajtim social dhe terapi fizikale. Përfitues të këtyre shërbimeve janë personat me aftësi të kufizuara mendore (ngecje në zhvillimin mendor), fizike dhe të kombinuara, të cilët jetojnë të vetëm, kanë anëtarë të ngushtë të familjes, por për arsye të ndryshme janë të penguar të ofrojnë përkujdesje për anëtarin e familjes në gjendje të nevojës sociale.

Skema për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara⁸

“Përkrahje materiale” është beneficion në formë të shumës financiare mujore ose formë tjetër e shpërblimit në të holla që administrohet nga MPMS-ja, për familje me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme “Fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme fizike, mendore dhe shqisore” konsiderohen fëmijët nga lindja deri në moshën 18 vjeçare me vendbanim të përhershëm në Kosovë, të cilët janë plotësisht të paaftë të kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore pa kujdesin e personit tjetër. Ndihma materiale familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme, do të ofrohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përmes Departamentit të saj të Mirëqenies Sociale. Ndihma materiale mundëson fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme të bëjnë një jetë më normale në kushtet që garantojnë dinjitetin e tyre dhe lehtësojnë jetën e tyre. Ndihma materiale për fëmijën e me aftësi të kufizuar të përhershme paguhet në emër të prindit apo kujdestarit të fëmijës, përmes xhirollogarisë bankare.

⁷ Definicioni për fëmijët e braktisur është marrë në Ligjin mbi familjen dhe marrëdhëniet e familjes nr. 10/84.

⁸ Definicioni për përkrahjen materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme është marrë në Ligjin nr. 03/L-022.

Ndihma dhe kujdesi për plotësimin e aktiviteteve të përditshme jetësore u takon fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme të moshës 1-18 vjeçare, që janë qytetarë të Kosovës dhe janë me aftësi të kufizuar të përhershme që në mënyrë të pavarur të lëvizin dhe t'i kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore, ku për këta persona është i nevojshëm kujdesi i huaj 24 orësh.

Fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme konsiderohen:

- a) fëmijët e palëvizshëm,
- b) fëmijët plotësisht të verbër si dhe,
- c) fëmijët të cilët për shkak të natyrës së sëmundjes apo sëmundjeve të përhershme, nuk janë të aftë që në mënyrë të pavarur të lëvizin vet, në banesë, apo në vendet ku kanë nevojë, as në përdorimin e ndihmesave përkatëse, nuk janë në gjendje të ushqehen vetë, të zhvishen dhe të vishen, të kryejnë nevojat fiziologjike si dhe të mbajnë higjienën e domosdoshme personale. Shuma mujore e pagesës është 100€.

Skema e ndihmës sociale⁹

Skema e ndihmës sociale ofron ndihmë të përkohshme financiare familjeve të cilat janë në varfëri dhe janë të përzgjedhura në përputhje me kriteret e parapara në ligj dhe në bazë të mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Kosovës.

Për të realizuar të drejtën në ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe t'i plotësojnë kushtet për kategorizim në njërin prej kategorive të përcaktuara me ligj. Përrjashtimisht, shfrytëzues të ndihmës sociale, mund të jenë edhe shtetasit e huaj të cilët: kanë leje qëndrimi në Kosovë, personat në cilësinë e azilkërkuesit, personat në cilësinë e refugjatit dhe personat të cilët gëzojnë mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese.

Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e parë e realizon familja në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur sipas përkufizimit të dhënë më poshtë të person i/e varur dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar.

Person i/e varur – përkufizohet si individ i cili i takon njërit prej grupeve që vijojnë: personat që janë mbi moshën tetëmbëdhjetë vjeç (18 vjeç) dhe të cilët kanë të meta të rënda dhe aftësi përherë të kufizuara që e bëjnë atë të paftë për të punuar për punë shpërblyese, personat që janë gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç apo më të moshuar, kujdestarët e përhershëm të personave me aftësi të kufizuara apo të personave në moshën 65 vjeç ose më të vjetër të cilëve u nevojitet kujdes i përhershëm, apo fëmija nën moshën 5 vjeç, personat deri në moshën 14 vjeç, personat

⁹ Definicioni për skemën e ndihmës sociale është marrë nga: Ligji nr.04/L-096.

ndërmjet moshave 15 dhe 18 vjeç dhe të cilët janë në shkollim të rregullt të mesëm, prindërit vetushqyes me së paku një fëmijë nën moshën 15 vjeç.

Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e dytë e realizon familja me një anëtar të familjes të aftë për punë (i cili duhet të jetë i regjistruar si i papunësuar në Zyrën e Punësimit) dhe me të paktën një fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç apo që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç.

Familjet që konsiderojnë se janë rast social sipas kategorisë së parë dhe të dytë i parashtrojnë kërkesë me shkrim për ndihmë sociale organit përkatës-Qendrave për Punë Sociale në komuna.

Familja e përzgjedhur për skemën e ndihmës sociale, për çdo fëmijë të moshës (0) deri tetëmbëdhjetë (18) vjeç, realizon një përfitim financiar prej 5 euro në formën e shtesës për fëmijë, me qëllim të nxitjes së arsimimit dhe përmirësimit të shëndetit.

Familja që fiton të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e parë do të marr ndihmë sociale deri në dymbëdhjetë (12) muaj.

Familja që fiton të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e dytë do të marr ndihmë sociale deri në gjashtë (6) muaj.

Pas kalimit të afatit të periudhës prej një (1) viti, përkatësisht, gjashtë (6) muaj, familja duhet të bëjë kërkesë të re për vazhdimin e të drejtës për ndihmë sociale.

Nga muaji nëntor 2015 ,shuma e pagesës së ndihmës sociale është rritur për 25%.

Shuma mujore e ndihmës sociale e cila iu paguhet familjeve në varfëri ndryshon, sa më i madh që të jetë numri i anëtarëve të familjeve si në vijim:

Familjet sipas numrit të anëtarëve	Shuma në €
Familja me një (1) anëtarë	50,00
Familja me dy (2) anëtarë	68,75
Familja me tre (3) anëtarë	75,00
Familja me katër (4) anëtarë	81,25
Familja me pesë (5) anëtarë	87,50
Familja me gjashtë (6) anëtarë	93,75
Familja me shtatë (7) anëtarë	100,00
Familja me tetë (8) anëtarë	106,25
Familja me nëntë (9) anëtarë	112,50
Familja me dhjetë (10) anëtarë	118,75
Familja me njëmbëdhjete(11) anëtarë	125,00
Familja me dymbëdhjetë (12) anëtarë	131,25
Familja me trembëdhjetë (13) anëtarë	137,50
Familja me katërbëdhjetë (14) anëtarë	143,75
Familja me pesëmbëdhjetë (15) anëtarë	150,00

Tabela 1. Numri i familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale sipas komunave

Komuna	TM1			TM2			TM3		
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
Deçan	309	307	310	280	314	317	318	322	326
Gjakovë	1.008	1.003	994	1.007	1.011	998	983	972	980
Glllogvc	1.072	1.046	1.071	1.107	1.108	1.098	1.090	1.080	1.096
Gjilan	738	731	742	757	752	745	740	740	756
Dragash	360	358	358	366	365	359	355	363	371
Istog	389	396	385	396	390	388	380	382	385
Kaçanik	797	806	801	789	790	803	798	798	810
Klinë	822	822	855	847	866	860	856	858	867
Fushë Kosovë	891	892	905	926	929	912	901	907	904
Kamenicë	585	584	591	599	597	588	584	577	574
Mitrovicë	2.292	2.289	2.308	2.302	2.324	2.295	2.273	2.277	2.263
Leposaviq	196	209	221	222	218	221	213	209	219
Lipjan	1.210	1.198	1.196	1.243	1.286	1.242	1.246	1.239	1.234
Novobërdë	483	487	500	514	513	506	500	505	509
Obiliq	768	773	766	771	792	777	771	777	775
Rahovec	628	629	629	643	644	642	644	642	649
Pejë	967	1.012	1.010	1.008	1.006	992	969	977	980
Podujevë	959	949	940	979	978	967	955	947	946
Prishtinë	1.463	1.456	1.455	1.500	1.499	1.488	1.472	1.480	1.489
Prizren	793	791	797	799	803	789	777	764	764
Skenderaj	775	757	765	801	803	795	791	803	812
Shtime	373	375	381	390	389	376	377	380	379
Shtërpcë	242	235	208	261	263	253	254	257	262
Suharekë	500	494	482	488	485	479	479	484	493
Ferizaj	951	958	946	966	974	961	949	952	944
Viti	452	441	442	461	465	458	467	475	470
Vushtrri	1.405	1.394	1.384	1.470	1.467	1.455	1.438	1.415	1.413
Zubin Potok	490	484	465	436	471	507	486	474	512
Zveçan	323	328	329	327	331	328	325	313	335
Malishevë	696	696	689	706	706	703	693	690	701
Junik	59	57	57	58	58	57	55	58	57
Mamushë	20	20	18	19	19	19	20	20	19
Hani i Elezit	129	127	127	129	128	126	122	122	122
Graçanicë	130	133	133	140	139	132	132	130	131
Ranillug	182	179	156	193	190	183	181	186	188
Partesh	47	50	54	54	53	54	54	54	51
Kllokot	134	132	141	141	141	139	140	136	133
Mitrovicë Veriore	591	580	587	602	597	603	585	574	577
G j i t h s e j	24.229	24.178	24.198	24.697	24.864	24.615	24.373	24.339	24.496

Bazuar në gjendjen e muajit shtator 2020, numri i familjeve që kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale ishte 24,496 familje. Numri më i madh i familjeve ishte në komunën e Mitrovicës me gjithsej 2,263 apo 9,2 % e numrit të përgjithshëm.

Tabela 2. Numri i anëtarëve të familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale sipas komunave

Komuna	TM1			TM2			TM3		
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
Deçan	1.201	1.205	1.209	1.094	1.224	1.237	1.248	1.262	1.287
Gjakovë	4.153	4.138	4.122	4.156	4.167	4.124	4.054	3.991	4.024
Gllgovc	4.754	4.649	4.772	4.921	4.915	4.874	4.837	4.779	4.846
Gjilan	2.865	2.798	2.850	2.894	2.874	2.850	2.813	2.809	2.869
Dragash	1.172	1.183	1.172	1.205	1.200	1.185	1.174	1.207	1.242
Istog	1.674	1.705	1.650	1.708	1.683	1.679	1.642	1.643	1.654
Kaçanik	3.410	3.462	3.434	3.387	3.386	3.450	3.415	3.430	3.476
Klinë	3.439	3.441	3.563	3.526	3.601	3.571	3.572	3.583	3.617
Fushë Kosovë	3.853	3.879	3.911	3.997	4.001	3.942	3.883	3.901	3.873
Kamenicë	2.239	2.247	2.261	2.293	2.286	2.258	2.239	2.215	2.207
Mitrovicë	9.554	9.547	9.646	9.611	9.694	9.568	9.483	9.485	9.431
Leposaviq	488	514	530	534	524	533	519	514	533
Lipjan	5.437	5.425	5.442	5.653	5.741	5.584	5.581	5.532	5.519
Novobërdë	1.604	1.615	1.654	1.698	1.698	1.664	1.643	1.654	1.658
Obiliq	3.185	3.196	3.152	3.145	3.257	3.213	3.180	3.196	3.195
Rahovec	2.628	2.630	2.626	2.680	2.695	2.693	2.700	2.692	2.706
Pejë	3.857	3.991	3.971	3.954	3.944	3.911	3.829	3.832	3.849
Podujevë	4.475	4.453	4.427	4.569	4.557	4.518	4.460	4.424	4.419
Prishtinë	5699	5676	5661	5.825	5.815	5.777	5.725	5.734	5.760
Prizren	2.977	2.983	2.990	3.003	3.014	2.990	2.918	2.873	2.871
Skenderaj	3.544	3.457	3.493	3.631	3.635	3.606	3.566	3.618	3.660
Shtime	1.731	1.742	1.767	1.806	1.802	1.751	1.759	1.776	1.774
Shtërpcë	844	801	719	901	908	880	892	907	926
Suharekë	2.259	2.232	2.172	2.210	2.209	2.190	2.179	2.199	2.239
Ferizaj	3.981	4.004	3.947	4.037	4.069	4.022	3.973	3.977	3.927
Viti	1.994	1.953	1.962	2.030	2.041	2.030	2.063	2.104	2.075
Vushtri	6.198	6.126	6.084	6.473	6.458	6.414	6.345	6.239	6.228
Zubin Potok	1.091	1.096	1.056	963	1.067	1.138	1.118	1.092	1.179
Zveçan	750	762	760	753	768	764	752	733	773
Malishevë	3.344	3.344	3.293	3.387	3.382	3.366	3.302	3.284	3.334
Junik	193	184	184	189	187	182	179	190	191
Mamushë	84	85	76	81	81	81	83	83	79
Hani i Elezit	534	526	527	537	535	529	507	503	501
Graçanicë	458	468	464	494	491	468	471	462	466
Ranillug	481	473	397	515	510	494	492	502	501
Partesh	130	141	155	155	152	155	156	156	152
Kllokot	477	471	503	502	502	493	497	486	482
Mitrovicë Veriore	1.457	1.456	1.468	1.500	1.494	1.528	1.473	1.451	1.467
Gj i t h e j	98.214	98.058	98.070	100.017	100.567	99.712	98.722	98.518	98.990

Bazuar në gjendjen e muajit shtator 2020, numri i anëtarëve të familjes që kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale ishte 98.990 anëtarë. Numri më i madh i anëtarëve ishte në komunën e Mitrovicës me gjithsej 9,431 apo 9,5 % e numrit të përgjithshëm.

Tabela 3. Numri i familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale sipas kategorive

Kategoritë	TM1			TM2			TM3		
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
	Familjet	Familjet	Familjet	Familjet	Familjet	Familjet	Familjet	Familjet	Familjet
1	16.594	16.560	16.637	17060	17194	16996	16883	16892	17055
2	7.635	7.618	7.561	7637	7670	7619	7490	7447	7441
Gjithsej	24.229	24.178	24.198	24.697	24.864	24.615	24.373	24.339	24.496

Tabela 4. Pensionet bazike të moshës sipas komunave

Komuna	TM1			TM2			TM3		
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
Deçan	3.343	3.320	3.440	3.481	3.486	3.493	3.508	3.508	3.506
Gjakovë	6.378	6.338	6.499	6.655	6.675	6.699	6.738	6.731	6.711
Glogoc	2.857	2.911	2.964	2.988	3.039	3.059	3.084	3.084	3.091
Gjilan	8.891	8.903	9.070	9.110	9.170	9.274	9.329	9.340	9.348
Dragash	4.531	4.480	4.590	4.637	4.663	4.706	4.769	4.769	4.753
Istog	4.352	4.374	4.450	4.485	4.502	4.522	4.538	4.551	4.547
Kaçanik	2.022	2.040	2.085	2.104	2.117	2.136	2.137	2.137	2.130
Klinë	3.305	3.344	3.409	3.450	3.470	3.500	3.524	3.549	3.569
Fushë Kosovë	2.230	2.274	2.326	2.329	2.358	2.386	2.400	2.404	2.402
Kamenicë	4.192	4.208	4.279	4.298	4.327	4.351	4.369	4.364	4.360
Mitrovicë	7.064	7.100	7.261	7.353	7.391	7.442	7.509	7.550	7.586
Leposaviq	3.417	3.538	3.584	3.627	3.628	3.631	3.659	3.664	3.672
Lipjan	4.426	4.437	4.573	4.627	4.663	4.696	4.721	4.703	4.705
Novobërdë	569	570	575	580	579	582	585	586	589
Obiliq	1.463	1.467	1.491	1.500	1.507	1.526	1.531	1.540	1.541
Rahovec	3.781	3.793	3.893	3.925	3.946	3.961	3.994	4.003	3.989
Pejë	8.251	8.269	8.471	8.547	8.612	8.655	8.717	8.752	8.744
Podujevë	5.053	5.143	5.228	5.279	5.315	5.398	5.423	5.422	5.436
Prishtinë	13.241	13.401	13.761	13.830	14.023	14.135	14.249	14.285	14.308
Prizren	11.820	11.840	12.095	12.152	12.272	12.319	12.362	12.324	12.313
Skenderaj	3.126	3.125	3.217	3.251	3.255	3.280	3.323	3.329	3.318
Shtime	1.721	1.724	1.768	1.782	1.808	1.822	1.826	1.823	1.821
Shtërpcë	2.240	2.158	2.287	2.295	2.299	2.317	2.322	2.321	2.325
Suharekë	4.391	4.417	4.485	4.511	4.547	4.603	4.620	4.631	4.624
Ferizaj	7.257	7.242	7.458	7.534	7.609	7.689	7.753	7.770	7.779
Viti	3.755	3.719	3.831	3.912	3.944	3.959	3.970	3.978	3.964
Vushtrri	4.222	4.269	4.368	4.429	4.480	4.512	4.523	4.528	4.531
Zubin Potok	1.113	1.118	1.133	1.140	1.141	1.142	1.164	1.189	1.202
Zveçan	1.461	1.473	1.496	1.506	1.506	1.500	1.517	1.518	1.528
Malishevë	3.183	3.178	3.242	3.263	3.284	3.288	3.302	3.334	3.326
Junik	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Mamushë	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Hani i Elezit	304	308	312	321	335	334	339	340	340
Graçanicë	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Ranillug	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Partesh	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Kllokot	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Mitrovicë Veriore	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Gj i t h s e j	133.959	134.481	137.641	138.901	139.951	140.917	141.805	142.027	142.058

Bazuar në gjendjen e muajit shtator 2020, numri i përfituesve nga skema e pensioneve bazike të moshës ishte 142,058. Numri më i madh i përfituesve ishte në komunën e Prishtinës me gjithsej 14,308 apo 10,1 % e numrit të përgjithshëm.

Grafikoni 1. Pensionet bazike të moshës sipas muajve





Tabela 5. Pensionet bazike të moshës sipas nacionalitetit, gjinisë dhe pagesa

Muajt	Shqiptar		Të tjerë ¹⁰		Gjithsej	Pagesa	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra			
TM1	Janar	34.605	73.617	11.610	14.127	133.959	€ 12.410.580,00
	Shkurt	34.663	74.013	11.643	14.162	134.481	€ 12.486.285,00
	Mars	35.556	75.810	11.880	14.395	137.641	€ 12.719.010,00
TM2	Prill	35.959	76.509	11.952	14.481	138.901	€ 16.660.050,00
	Maj	36.435	77.036	11.984	14.496	139.951	€ 16.903.920,00
	Qershor	36.673	77.640	12.036	14.568	140.917	€ 17.077.035,00
TM3	Korrik	37.024	78.022	12.104	14.655	141.805	€ 12.911.895,00
	Gusht	37.130	78.123	12.125	14.649	142.027	€ 12.924.045,00
	Shtator	37.141	78.044	12.167	14.706	142.058	€ 12.907.050,00

Grafikoni 2. Pensionet bazike të moshës sipas nacionalitetit në përqindje

¹⁰ Në të tjerët janë të përfshirë numri i serbëve dhe nacionaliteteve të tjera joshqiptare që jetojnë në Kosovë dhe që përfitojnë nga pensioni bazik i moshës.

Tabela 6. Pensionet kontribut paguese të moshës sipas muajve

Komuna	TM1			TM2			TM3		
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
Deçan	700	695	717	720	722	721	721	717	720
Gjakovë	3.669	3.678	3.767	3.800	3.818	3.840	3.850	3.835	3.825
Glogoc	1.072	1.099	1.124	1.137	1.144	1.159	1.167	1.172	1.178
Gjilan	2.042	2.061	2.092	2.092	2.109	2.125	2.128	2.116	2.120
Dragash	605	602	606	609	606	608	613	615	607
Istog	740	746	759	760	766	768	771	771	771
Kaçanik	780	792	805	806	807	817	823	822	817
Klinë	643	646	657	658	664	668	669	669	669
Fushë Kosovë	1.066	1.078	1.099	1.112	1.122	1.138	1.143	1.136	1.141
Kamenicë	567	566	574	578	580	583	580	582	582
Mitrovicë	3.549	3.571	3.641	3.645	3.678	3.688	3.689	3.677	3.662
Leposaviq	11	10	12	12	12	12	12	12	12
Lipjan	1.269	1.282	1.312	1.327	1.340	1.345	1.347	1.345	1.341
Novobërdë	38	36	37	37	37	36	36	36	36
Obiliq	706	707	717	721	726	739	742	750	754
Rahovec	758	757	777	774	775	783	780	781	780
Pejë	3.648	3.668	3.730	3.736	3.752	3.757	3.780	3.773	3.770
Podujevë	1.769	1.783	1.806	1.818	1.836	1.854	1.846	1.837	1.827
Prishtinë	9.733	9.836	10.002	10.069	10.127	10.219	10.231	10.238	10.254
Prizren	5.146	5.179	5.226	5.214	5.220	5.310	5.318	5.303	5.291
Skenderaj	995	1.000	1.021	1.025	1.026	1.037	1.037	1.034	1.022
Shtime	394	395	402	405	403	410	408	411	412
Shtërpcë	44	45	46	45	42	42	41	42	42
Suharekë	1.159	1.164	1.178	1.181	1.182	1.205	1.219	1.227	1.236
Ferizaj	2.708	2.716	2.781	2.804	2.829	2.856	2.855	2.858	2.861
Viti	596	588	599	603	610	613	616	618	612
Vushtri	2.357	2.367	2.406	2.413	2.442	2.450	2.453	2.448	2.435
Zubin Potok	36	35	35	36	37	38	39	39	40
Zveçan	18	18	18	18	18	18	18	18	17
Malishevë	502	502	508	507	507	510	513	514	507
Junik	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Mamushë	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Hani i Elezit	183	186	191	190	193	198	200	199	200
Graçanicë	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Ranillug	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Partesh	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Kllokot	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Mitrovicë Veriore	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Gj i t h s e j	47.503	47.808	48.645	48.852	49.130	49.547	49.645	49.595	49.541

Bazuar në gjendjen e muajit shtator 2020, numri i përfituesve nga skema e pensioneve kontribut pagues të moshës ishte 49,541. Numri më i madh i përfituesve ishte në komunën e Prishtinës me gjithsej 10,254 apo 20.7 % e numrit të përgjithshëm.

Grafikoni 3. Pensionet kontribut pagues të moshës sipas muajve





Tabela 7. Pensionet kontribut pagues të moshës sipas nacionalitetit gjinisë dhe pagesa

Muajt	Shqiptar		Të tjerë ¹¹		Gjithsej	Pagesa	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra			
TM1	Janar	39.413	7.165	774	151	47.503	€ 9.781.637,00
	Shkurt	39.622	7.252	777	157	47.808	€ 9.887.820,00
	Mars	40.278	7.423	786	158	48.645	€ 9.993.341,00
TM2	Prill	40.420	7.486	787	159	48.852	€ 9.855.545,00
	Maj	40.615	7.566	787	162	49.130	€ 9.981.375,00
	Qershor	40.890	7.700	795	162	49.547	€ 10.119.075,00
TM3	Korrik	40911	7766	799	169	49.645	€ 10.059.577,00
	Gusht	40.840	7.796	793	166	49.595	€ 10.063.385,00
	Shtator	40.762	7.826	787	166	49.541	€ 10.047.730,00

Grafikoni 4. Pensionet kontribut pagues të moshës sipas nacionalitetit në përqindje



¹¹ Në të tjerët janë të përfshirë numri i serbëve dhe nacionaliteteve të tjera joshqiptare që jetojnë në Kosovë dhe që përfitojnë nga pensioni kontribut pagues i moshës.

Tabela 8. Pensionet e personave me aftësi të kufizuara sipas komunave

Komuna	TM1			TM2			TM3		
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
Deçan	250	266	263	336	334	331	307	323	335
Gjakovë	896	905	916	1.101	1.093	1.083	1.029	1.076	1.118
Glllogovc	376	387	407	452	451	452	408	434	438
Gjilan	959	966	978	1.212	1.217	1.216	1.187	1.195	1.169
Dragash	278	298	305	363	360	356	345	345	453
Istog	341	362	360	450	450	446	411	441	335
Kaçanik	297	290	285	376	376	372	324	366	367
Klinë	338	361	344	420	418	415	384	405	415
Fushë Kosovë	305	309	332	365	362	362	333	351	350
Kamenicë	308	307	318	410	407	404	395	392	389
Mitrovicë	1.066	1.083	1.101	1.266	1.255	1.246	1.118	1.193	1.221
Leposaviq	100	101	101	133	132	130	83	90	86
Lipjan	570	585	647	705	699	697	641	669	664
Novobërdë	34	29	31	41	41	41	41	41	42
Obiliq	175	181	187	197	196	195	180	188	190
Rahovec	441	445	443	541	544	540	504	529	522
Pejë	853	906	896	1.074	1.067	1.052	976	1.030	1.071
Podujevë	801	819	884	967	963	958	875	936	929
Prishtinë	1.678	1.728	1.796	1.921	1.914	1.913	1.733	1.840	1.838
Prizren	1.578	1.713	1.704	1.897	1.889	1.878	1.822	1.843	1.843
Skenderaj	507	510	507	603	600	595	566	588	604
Shtime	182	179	182	237	236	234	217	235	244
Shtërpcë	75	74	73	97	95	94	75	90	89
Suharekë	519	557	555	629	629	626	612	619	608
Ferizaj	937	948	965	1.200	1.189	1.177	1.064	1.158	1.156
Viti	331	337	345	463	464	461	449	453	455
Vushtri	915	945	932	1.110	1.097	1.091	1.016	1.049	1.077
Zubin Potok	22	21	20	30	30	29	19	24	22
Zveçan	9	11	9	11	11	11	8	10	9
Malishevë	370	379	375	494	494	494	462	486	476
Junik	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Mamushë	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Hani i Elezit	46	43	43	53	52	51	48	51	50
Graçanicë	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Ranillug	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Partesh	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Kllokot	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Mitrovicë Veriore	:	:	:	:	:	:	-	-	-
Gjithsej	15.557	16.045	16.304	19.154	19.065	18.950	17.632	18.450	18.565

Bazuar në gjendjen e muajit shtator 2020, numri i përfituesve nga skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara ishte 18,565. Numri më i madh i përfituesve ishte në komunën e Prizrenit me gjithsej 1,843 apo 9,9 % e numrit të përgjithshëm.

Grafikoni 5. Pensionet e personave me aftësi të kufizuara sipas muajve





Tabela 9. Pensionet e personave me aftësi të kufizuara sipas nacionalitetit, gjinisë dhe pagesa

Muajt	Shqiptar		Të tjerë ¹²		Gjithsej	Pagesa	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra			
TM1	Janar	6.891	7.292	718	656	15.557	€ 1.247.400,00
	Shkurt	7.139	7.496	737	673	16.045	€ 1.437.795,00
	Mars	7.305	7.552	741	706	16.304	€ 1.437.375,00
TM2	Prill	8.547	8.855	911	841	19.154	€ 2.027.070,00
	Maj	8.508	8.820	904	833	19.065	€ 2.019.525,00
	Qershor	8.458	8.772	896	824	18.950	€ 2.031.980,00
TM3	Korrik	7.985	8.162	781	704	17.632	€ 1.867.650,00
	Gusht	8.289	8.576	830	755	18.450	€ 1.563.270,00
	Shtator	8.334	8.664	817	750	18.565	€ 1.617.525,00

Grafikoni 6. Pensionet e personave me aftësi të kufizuara sipas nacionalitetit në përqindje



¹² Në të tjerët janë të përfshirë numri i serbëve dhe nacionaliteteve të tjera joshqiptare që jetojnë në Kosovë dhe që përfitojnë nga pensioni i personave me aftësi të kufizuara.

Tabela 10. Skema për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara sipas komunave (0-18) vjeç

Komuna	TM1			TM2			TM3		
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
Decan	41	41	44	44	44	43	42	43	43
Gjakovë	114	112	118	117	115	114	113	116	115
Gllgovc	72	71	78	77	77	75	81	81	80
Gjilan	133	133	136	136	135	132	133	132	132
Dragash	22	21	24	24	24	24	24	25	25
Istog	51	51	57	57	55	54	53	53	53
Kacanik	47	47	49	48	48	47	47	49	49
Kline	49	49	51	52	52	52	52	55	53
Fushë Kosovë	68	68	76	76	76	76	78	77	78
Kamenicë	36	36	37	36	35	35	37	37	36
Mitrovicë	120	120	124	124	123	122	120	124	123
Leposaviq	13	13	13	12	12	12	12	12	12
Lipjan	89	89	92	93	92	92	92	92	92
Novobërdë	21	20	20	20	20	19	20	20	20
Obiliq	32	32	36	35	35	35	34	36	36
Rahovec	66	66	69	68	67	65	65	67	65
Pejë	84	84	94	93	91	91	89	94	94
Podujevë	92	91	94	94	92	92	94	94	93
Pristinë	309	306	314	312	310	307	310	315	312
Prizren	193	192	199	196	195	193	193	201	200
Skenderaj	73	73	78	78	77	77	77	78	77
Shtime	28	28	30	30	30	29	29	29	28
Shtërpce	18	18	18	18	18	18	18	18	18
Suharekë	62	61	64	64	62	62	62	61	61
Ferizaj	118	119	122	121	120	119	124	124	122
Viti	49	46	46	46	46	46	46	45	44
Vushtrri	108	108	113	113	111	110	108	109	109
Zubin Potok	12	11	12	12	12	12	12	12	12
Zvecan	6	6	6	6	6	6	6	6	6
Malishevë	58	58	68	66	66	67	66	69	69
Junik	:	:	:	-	-	-	-	-	-
Mamusha	3	3	4	4	4	4	4	4	4
Hani I Elezit	10	10	11	11	11	11	11	11	11
Graçanicë	23	23	24	24	24	24	24	23	23
Ranillug	3	3	3	3	3	3	3	3	3
Partesh	3	3	3	3	3	3	3	3	3
Kllokot	6	6	6	6	6	6	6	6	5
Mitrovicë Veriore	23	23	25	24	24	24	24	27	27
Gjithsej	2.255	2.241	2.358	2.343	2.321	2.301	2.312	2.351	2.333

Bazuar në gjendjen e muajit shtator 2020, numri i përfituesve nga skema për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara ishte 2,333. Numri më i madh i përfituesve ishte në komunën e Prishtinës me gjithsej 312, apo 13,4% e numrit të përgjithshëm.

Grafikoni 7. Skema për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara sipas muajve




Tabela 11. Pensionet Familjare sipas komunave

Komuna	TM1			TM2			TM3		
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
Deçan	41	41	42	38	36	38	39	37	36
Gjakovë	327	334	331	332	329	327	326	319	315
Glogovc	98	97	97	94	93	89	91	90	92
Gjilan	179	177	178	176	175	173	169	169	165
Dragash	28	26	27	26	26	23	22	22	22
Istog	73	73	70	68	66	65	64	65	63
Kacanik	163	160	157	153	149	147	147	147	146
Kline	42	42	42	39	38	36	38	38	39
Fushë Kosovë	86	85	84	82	82	78	77	75	76
Kamenicë	51	51	46	45	43	44	45	43	43
Mitrovicë	333	329	322	314	309	307	301	299	302
Leposaviq	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Lipjan	128	126	125	123	119	118	117	116	114
Novobërdë	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Obiliq	71	71	68	68	67	66	66	64	63
Rahovec	113	113	113	111	109	108	107	107	106
Pejë	299	294	297	295	289	290	285	285	293
Podujevë	165	166	165	164	161	161	158	158	157
Prishtinë	495	496	489	473	469	460	453	456	453
Prizren	476	473	467	459	447	433	432	436	437
Skenderaj	59	58	58	59	57	58	59	59	61
Shtime	32	31	29	28	27	27	26	26	26
Shtërpce	6	6	6	6	6	6	6	6	6
Suharekë	97	103	101	101	100	99	100	101	101
Ferizaj	207	207	206	202	197	193	191	191	191
Viti	46	46	46	46	46	46	47	47	48
Vushtri	223	226	222	217	213	214	215	215	215
Zubin Potok	2	2	2	2	2	3	3	3	3
Zvecan	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Malishevë	55	55	55	54	51	51	50	51	53
Junik	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Mamusha	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Hani i Elezit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Graçanicë	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Ranillug	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Partesh	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kllokot	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Mitrovicë Veriore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	3.898	3.891	3.848	3.778	3.709	3.663	3.637	3.628	3.629

Tabela 12. Pensionet e Invalidëve të punës sipas komunave

Komuna	TM1			TM2			TM3		
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
Deçan	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjakovë	11	11	9	9	7	6	6	6	6
Glogoc	5	5	5	5	5	5	5	5	5
Gjilan	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Dragash	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Istog	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Kacanik	4	4	3	3	3	3	3	3	3
Kline	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Fushë Kosovë	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Kamenicë	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Mitrovicë	6	6	6	6	6	6	6	6	6
Leposaviq	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Lipjan	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Novobërdë	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Obiliq	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Rahovec	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Pejë	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Podujevë	10	10	9	9	9	9	9	9	9
Prishtinë	21	20	17	16	15	15	15	15	14
Prizren	26	27	27	27	26	25	25	24	23
Skenderaj	1	1	1	1	-	-	-	-	-
Shtime	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shtërpce	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Suharekë	4	4	4	4	4	4	4	4	4
Ferizaj	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Viti	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Vushtri	7	7	7	7	7	7	6	6	6
Zubin Potok	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Zvecan	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Malishevë	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Junik	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Mamusha	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Hani i Elezit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Graçanicë	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Ranillug	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Partesh	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kllokot	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Mitrovicë Veriore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	106	106	99	98	93	91	90	89	87

Tabela 13. Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike sipas komunave

Komuna	TM1			TM2			TM3		
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
Decan	73	72	72	72	72	72	68	68	66
Gjakovë	185	184	184	184	184	182	165	168	167
Glogoc	98	100	100	100	100	100	97	97	95
Gjilan	183	182	183	182	181	180	173	175	169
Dragash	58	59	58	58	58	58	56	57	55
Istog	99	98	98	98	95	95	91	89	87
Kacanik	82	82	82	82	82	82	77	80	78
Kline	64	66	66	66	65	64	58	58	58
Fushë Kosovë	71	72	70	70	70	70	68	69	67
Kamenicë	54	52	53	53	53	52	49	51	51
Mitrovicë	171	171	170	169	169	169	149	159	157
Leposaviq	5	5	5	5	5	5	5	5	5
